



Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

RAPORT MBI VLERËSIMIN E ANËTAREVE TË RRGK-SË 2022

Janar 2023

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	3
HYRJE	5
NJË PASQYRË MBI ANËTARËSINË E RRGK-SË.....	6
I. MISIONI DHE PROGRAMET.....	6
II. QEVERISJE E MIRË	7
III. BURIMET NJERËZORE.....	7
IV. FINANCIMI, TRANSPARENCA DHE PËRGJEGJËSIA FINANCIARE	8
V. VIZIBILITETI.....	10
VI. SFIDAT DHE NEVOJAT	11
REKOMANDIME PËR NGRITJEN E KAPACITETEVE PËR ANËTARET	12
REKOMANDIME KYÇE PËR FONDIN E GRAVE TË KOSOVËS.....	12
SHTOJCA I. APLIKACION PËR ANËTARËSIM NË RrGK.....	14

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në nëntor 2022, Kuvendi i Anëtareve të Rrjetit të Grave të Kosovës (RrGK) miratoi Rregulloren e re të Anëtarësisë dhe Kodin e Sjelljes. Si rezultat i kësaj, të gjitha 194 organizatave anëtare të RrGK-së iu kërkua të përditësojnë aplikacionet e tyre për anëtarësim në RrGK. Ky proces kishte për synim të siguronte që të gjitha anëtarët ishin të vetëdijshme, ishin ende dakord dhe po merrnin hapa për të siguruar zbatimin e Rregullores së Anëtarësisë dhe Kodit të Sjelljes. Procesi i takimit të stafit të RrGK-së me anëtarët e RrGK-së gjithashtu ofroi mundësi për të vlerësuar nevojat e anëtareve tona. Gjetjet do të ofrojnë mbështetje RrGK-së në dizajnimin e shërbimeve më efektive për anëtarët tona, duke përfshirë përmirësimin e Fondit të Grave të Kosovës (FGK) për të përmbushur më mirë nevojat e anëtareve. Që nga janari 2023, 135 anëtare të RrGK-së i kishin përditësuar aplikacionet e tyre për anëtarësim në RrGK dhe morën pjesë në vlerësimin e nevojave të anëtareve të RrGK-së. Gjetjet kryesore përfshijnë:

- 40% (55 anëtare) kanë strategji të qarta që udhëheqin punën e tyre.
- 22% (30 anëtare) u mungon një bord aktiv.
- 42% (57 anëtare) janë organizata të anëtarësisë, me një mesatare prej 275 anëtaresh për organizatë
- 48% (58 anëtare) kanë shkruar rregullore të punës dhe standarde të sjelljes që rregullojnë punën e tyre.
- 68% (93 anëtare) angazhojnë staf, nga të cilët 85% (79 anëtare) paguajnë rregullisht anëtarët e stafit.
- Nga ato që angazhojnë staf, shumica, pra 58% (54 anëtare) kanë 1-5 anëtarë të stafit
- 87% (118 organizata) angazhojnë vullnetarë. Mesatarisht, secila anëtare e RrGK-së angazhon 15 vullnetarë. Disa anëtarë të stafit të anëtareve punojnë në baza vullnetare, kjo zakonisht për shkak të mungesës së fondeve.
- Vetëm 31% (42 anëtare) kanë burime të mjaftueshme financiare për të kompensuar në mënyrë adekuate stafin e tyre.
- Mesatarisht, çdo anëtare mbështet afërsisht 135 njerëz në vit. Në vitin 2022, anëtarët e RrGK-së kishin më shumë se 97,172 përfituese në total.
- 91% (123 anëtare) e anëtareve të RrGK-së kanë marrë ndonjëherë fonde, kurse 9% (12 anëtare) nuk kanë marrë kurrë fonde.
- 61% (83 anëtare) kanë pranuar grante në vitin 2022; 13% (18 anëtare) kanë marrë fonde për herë të fundit në vitin 2021; dhe 16% (22 anëtare) nuk kanë pranuar grante në tre vitet e fundit ose më shumë.
- Me këtë vlerësim u zbulua se të ardhurat mesatare vjetore të anëtareve ishin 32,500 €, duke përfshirë edhe ato pa të hyra. Megjithatë, disa organizata më të mëdha (14) rritën mesataren e përgjithshme. Anëtarët e RrGK-së dallojnë mjaft shumë për sa i përket të ardhurave të tyre vjetore. Nga 61% që kanë pranuar fonde në vitin 2022, 7% kanë marrë më pak se 1,000 €, 22% kanë marrë 1,000 € deri në 5,000 €, 15% kanë marrë 5,000 € deri në 10,000 €, 17% kanë marrë €10,000 deri në 20,000 €, 13% kanë marrë 20,000 € deri në 50,000 €, 11% kanë marrë më shumë se 50,000 € dhe 16% kanë marrë më shumë se 100,000 €
- Nga 83 organizata që raportuan se kishin marrë fonde në vitin 2022, 33% kishin siguruar fonde për një projekt, 27% për dy projekte, 18% për tre projekte dhe 22% për më pak se katër ose më shumë projekte të ndryshme.
- Mesatarisht, kohëzgjatja e projekteve në mesin e anëtareve të RrGK-së ishte 8 muaj. 86% e projekteve zgjatën deri në 12 muaj, 9% deri në 24 muaj, 3% deri në 36 muaj dhe vetëm 1% më shumë se 36 muaj.
- Shumica e anëtareve të RrGK-së (40%) marrin fonde nga qeveria, kurse 28% marrin mbështetje nga donatorët vendorë. Nga ato që marrin fonde vendore, FGK mbështeti 69%. Me fjalë të tjera, përafërsisht 26% e anëtareve të RrGK-së kanë marrë mbështetje nga FGK vetëm në vitin 2022.
- Vetëm 19% (26 anëtare) kanë buxhete vjetore organizative.
- Gati të gjitha anëtarët (99%) dorëzojnë raporte narrative dhe financiare tek donatorët.
- Vetëm 17% (24 anëtare) kanë bërë auditim organizativ vjetor në vitin 2022.

- 68% (93 anëtare) kanë hapësira të dedikuara për zyre për punën e tyre.
- 39% kanë përgatitur raportin vjetor dhe më pak se 1% e kanë shpërndanë ose promovuar atë.
- Sfida kryesore e anëtareve të RrGK-së është mungesa e fondeve. Sfida të tjera të ndërlidhura përfshijnë: mungesën e stafit, objektet për zyra, pajisjet, përfaqësimin politik, transportin dhe mundësitë e ngritjes së kapaciteteve, si dhe kërcënimet.
- Nevojat e tyre të cilat i shprehën përfshinin: grante afatgjata (62%), më pak barrë administrative sa i përket granteve (52%), grante më të mëdha (51%) dhe grante më fleksibël (18%). Disa donin gjithashtu të kishte thirrje më të shpeshta për propozime nga FGK-ja.
- Ndër nevojat për ngritjen e kapaciteteve ishin: më shumë informata rreth mundësive të ndryshme sa i përket ngritjes së kapaciteteve (47%) dhe mbështetje në menaxhim financiar (47%), planifikim strategjik (45%), informata në lidhje me mundësitë e financimit (32%), mbledhjen e fondeve (16%), përfaqësimin politik (14%), marrëdhëniet me publikun (7%) dhe avokimin (6%).

Si përfundim, anëtarët e RrGK-së kanë potencial të konsiderueshëm, por ka hapësirë për përmirësim në strukturat dhe politikat organizative. RrGK-ja, duke përfshirë edhe FGK-në, mund të ofrojë mbështetje shtesë në ngritjen e kapaciteteve, reduktimin e barrës administrative si dhe ndihmë anëtareve që të kenë më shumë mundësi fleksibile financimi.

HYRJE

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) është organizatë joqeveritare, jofitimprurëse, me mision që të përkrahë, të mbrojë dhe të promovojë të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në të gjithë Kosovën, pavarësisht nga përkatësia e tyre politike, fetare, etnike, mosha, niveli i arsimit, orientimi seksual dhe aftësia. RrGK e realizon këtë mision përmes shkëmbimit të përvojës dhe informatave, partneriteteve dhe rrjetëzimit, hulumtimeve, avokimit dhe shërbimeve. Si rrjet i organizatave të etnive të ndryshme në gjithë Kosovën, anëtarët e RrGK-së ndërmarrin iniciativë të rëndësishme drejt avancimit të të drejtave të njeriut, sipas qëllimeve të përcaktuara në [Strategjinë e RrGK-së](#).

Zhvendosja e prioritetëve të ndihmës dhe zvogëlimi i buxheteve kanë bërë që shumë donatorë në Kosovë të mbyllin programet e tyre të granteve ose të ulin fondet për organizatat joqeveritare (OJQ). Donatorë të tjerë kanë fonde në dispozicion, por kanë procedurë të vështira aplikimi dhe/ose japin vetëm grante të konsiderueshme sizeable. Grupet e grave me burime të kufizuara njerëzore me orar të plotë dhe njohuri të gjuhës angleze përballen me vështirësi në marrjen e fondeve për iniciativat e tyre të rëndësishme drejt barazisë gjinore dhe të drejtave të grave.


Prandaj, RrGK në konsultim të ngushtë me anëtarët e saj dhe mbështetur nga Fondacioni Kvinna till Kvinna themeloi Fondin e Grave të Kosovës (FGK) në vitin 2012. Fondi ofron grante të vogla për organizatat për të drejtat e grave (OSHCG), ndër të tjera, në Kosovë dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor. FGK-ja unike ofron gjithashtu mundësi të vazhdueshme, të përshtatura për zhvillimin e kapaciteteve për pranuesit e granteve, si dhe aplikantët e granteve, në shkrimin e granteve, menaxhimin e ciklit të projektit dhe menaxhimin financiar, duke rritur kështu kapacitetet e tyre për të aplikuar për financim nga donatorë të tjerë në të ardhmen, e duke përdorur qasjen novatore “learning by doing të mësuarit përmes veprimit”.

Përmes sistemeve dhe procedurave transparente, efikase, efektive dhe të dëshmuara të nën-granteve të FGK-së, që nga themelimi i FGK-së, RrGK ka administruar 225 grante për 107 OSHCG-të që nuk merrnin mjaft ndihmë me vlerë prej 1,477,067 €. nga dhjetori 2012, 24,387 gra dhe vajza nga zona të ndryshme, si dhe djem dhe burra, kanë përfituar drejtpërdrejt nga iniciativat e OSHCG-ve. Në mesin e tyre, 4,717 gra morën pjesë në proceset vendimmarrëse (disa për herë të parë), përfshirë edhe gjatë 511 iniciativave avokuese të ndërmarra, përmes të cilave 31 politika publike u ndryshuan për të mbështetur më mirë nevojat e grave dhe vajzave në Kosovë.

FGK ka marrë mbështetje nga Bashkimi Evropian, Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar, Agjencia Austriake për Zhvillim, Fondacioni Kvinna till Kvinna, UN Women, Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA) dhe Sigrid Rausing Trust.

NJË PASQYRË MBI ANËTARËSINË E RRGK-SË

Pas miratimit të Rregullores dhe Kodit të Sjelljes së Anëtareve të RrGK-së në nëntor 2022, që nga janari 2023, 135 organizata e kishin përditësuar aplikacionin e tyre për anëtarësim (Lista e anëtareve të RrGK-së¹). Thuajse të gjitha organizatat anëtare të RrGK-së (91%) udhëhiqen nga gratë dhe 8% nga burrat. Shumica e organizatave anëtare të RrGK janë themeluar para vitit 2010 dhe kanë ekzistuar mesatarisht 20 vjet. Për më tepër, 27% e anëtareve kanë qenë të ndërlidhura me RrGK-në për më shumë se një dekadë, dhe 33% për më shumë se dy dekada. Mesatarisht, anëtarët e RrGK kanë qenë të ndërlidhura me RrGK-në për nëntë vjet. Sa i përket vendndodhjes së tyre gjeografike, shumica e anëtareve të RrGK-së janë të vendosura në Prishtinë (35%), por ato operojnë në më shumë se 70% të komunave të Kosovës.² Në Grafikon I është e paraqitur vendndodhja e anëtareve të RrGK-së sipas komunave.



I. MISIONI DHE PROGRAMET


Të gjitha anëtarët e RrGK-së që kanë përditësuar aplikacionet e tyre për anëtarësim kanë përcaktuar misionin e organizatës së tyre në statutet e tyre, siç kërkohet me Ligjin Nr. 04/L-057 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare.³ Gjithsej, 55 anëtare të RrGK-së (40% e anëtareve) kanë zhvilluar strategji të qarta që udhëheqin punën e tyre. Anëtarët e RrGK-së përqendrohen në fuqizimin ekonomik (18%); arsimin (14%); barazinë gjinore (12%); të drejtat e njeriut, të drejtat e grave, të drejtat e fëmijëve (12%); dhe adresimin e dhunës me bazë gjinore, dhunës në familje dhe trafikimit (përfshirë

¹ Numri mund të ndryshojë me bashkëngjitjen e anëtareve të reja. Informacioni i përditësuar rreth anëtareve është i disponueshëm në faqen e internetit të RrGK-së: <https://womensnetwork.org/members-main/>.

² Anëtarët e RrGK-së nuk kanë cekur se operojnë në komunat e mëposhtme: Dragash, Klinë, Leposaviq, Shtërpçë, Suharekë, Zubin Potok, Zveçan, Hani i Elezit, Junik, Mamushë and Ranillug.

³ Ligji Nr. 04/L-057 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, neni 6.3, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2764>.

strehimoret) (9%). Grafiku 2 tregon përqindjen e anëtarëve të RrGK-së sipas fushave kryesore të punës së tyre.



II. QEVERISJE E MIRË


Sipas nenit 13.2 të Ligjit Nr. 04/L-057 për Lirinë e Asociimit, të gjitha OJQ-të duhet të kenë një Bord që përbëhet nga së paku tre anëtarë. Megjithatë, 22% e anëtarëve të RrGK-së deklaruan se nuk kanë bord aktiv. Prej 78% të anëtarëve që kanë borde aktive, vetëm 0.6% kanë deklaruar se kanë numër çift anëtarësh të bordit, gjë që mund të pengojë votimin. 37% bi-annually, 19% tri-annually and 10% quarterly. Sa i përket mbledhjeve të bordit, të gjitha anëtarët që kanë bord aktiv thanë se mbajnë mbledhje të rregullta të bordit: 26% të paktën një herë në vit, 37% çdo dy vite, 19% çdo tre vjet dhe 10% çdo tremujor.

Në përgjithësi, 42% e anëtarëve të RrGK-së janë organizata anëtare me një mesatare prej 275 anëtare për organizatë. Numri i përgjithshëm i anëtarëve të tyre është 13,928 persona.


Lidhur me rregulloret e punës, 48% e anëtarëve kanë shkruar rregullore të punës dhe standarde të sjelljes që rregullojnë punën dhe veprimet e tyre

III. BURIMET NJERËZORE

Sa u përket burimeve njerëzore, 68% e anëtarëve (93 organizata) angazhojnë staf për zbatimin e aktiviteteve të tyre të përditshme. Nga anëtarët që angazhojnë staf, 85% e tyre (79 anëtare) thanë se kishin burime për të paguar punonjësit e rregullt. Siç ilustron Grafiku 3, shumica e anëtarëve të RrGK-së që kanë staf (54) angazhojnë 1-5 anëtarë të stafit. Nga këto, vetëm 31% (42 organizata) kanë burimet e nevojshme financiare për të paguar në mënyrë adekuate stafin e tyre. Gjithashtu, 15% (20 anëtare) angazhojnë 6-10 staf, nga të cilat 15 kanë kapacitet financiar për ta paguar atë. Shtatë për qind (9 anëtare) angazhojnë 11-20 punonjës, nga të cilat 8 kanë mundësi financiare për t'i kompensuar ata. Për më tepër, 3% (katër anëtare) angazhojnë 21-30 anëtarë të stafit dhe të gjitha kanë kapacitete financiare për të paguar stafin e tyre. Një anëtare e RrGK-së ka të punësuar 31-40 persona, kurse një anëtare tjetër ka staf prej 41-50 anëtarë, e të gjithë me pagesë. Kjo sugjeron që organizatat me më shumë staf priren të jenë më në gjendje të paguajnë stafin e tyre gjithashtu.




Sa i përket vullnetarëve, shumica e anëtareve të RrGK-së (118 organizata, 87% e anëtareve) angazhojnë vullnetarë. Mesatarisht, secila organizatë anëtare e RrGK-së angazhon 15 vullnetarë. Shumica e anëtareve të RrGK-së (104 organizata, 77% e anëtareve) shprehën nevojën për të përfshirë më shumë vullnetarë në punën e tyre. Grafiku 4 ilustron fushat kryesore në të cilat anëtarët e RrGK-së kërkuan mbështetje nga vullnetarët.



Anëtarët e RrGK-së gjithashtu përfshijnë rregullisht përfituesit në punën e tyre. Mesatarisht, secila organizatë mbështet afërsisht 135 njerëz në vit. Në vitin 2022, anëtarët e RrGK-së thanë se në total kishin më shumë se 97,172 përfitues.

IV. FINANCIMI, TRANSPARENCA DHE PËRGJEGJËSIA FINANCIARE

Vetëm 19% e organizatave anëtare të RrGK-së thanë se përpilojnë buxhet organizativ çdo vit. Në përgjithësi, 91% e anëtareve të RrGK-së kishin marrë ndonjëherë fonde (123), dhe 9% nuk kishin marrë kurrë fonde (12). Këto të fundit punonin në baza vullnetare. Ato që kishin marrë fonde u pyetën se kur morën fonde për herë të fundit dhe 61% u përgjigjen se kishin marrë një ose më shumë grante në vitin 2022 (83); 13% thanë se viti 2021 ishte viti i fundit në të cilin morën fonde; dhe të tjerat (16%) nuk kishin marrë grante në tre vitet e fundit ose më shumë. Në vitin 2022, nga 61% e anëtareve të RrGK-së që morën grante, këto ishin mesatarisht 32,500€ për grant. Grafiku 5 ilustron shumën e financimit (në euro) të marrë nga këto 83 organizata. Prej tyre, 7% kanë marrë më pak se 1,000 €, ndërsa 22% kanë marrë fonde në shumë prej 1,000€ deri në 5,000€. Ndërkohë, 15% kanë marrë fonde në shumë prej 5,000 € deri në 10,000 €, dhe 17% kanë marrë fonde në vlerën prej 10,000 € deri në 20,000 €. Më tej, 13% e organizatave siguruan fonde që varionin nga 20,000 € deri në 50,000 €, dhe 11% morën më shumë se 50,000 €. Së fundi, 16% kanë marrë fonde në vlerë prej më shumë se 100,000 €.




Për sa i përket numrit të projekteve të siguruar, nga 83 organizata që raportuan se kishin financim në vitin 2022, 33% kishin një projekt, 27% kishin dy projekte, 18% kishin tre dhe 22% kishin katër ose më shumë projekte të ndryshme.

Siç ilustron Grafiku 6, 86% e projekteve të anëtareve zgjatën deri në një vit, 9% deri në dy vjet, 3% deri në tre vjet dhe vetëm 1% kishin projekte që kanë zgjatur më shumë se tre vjet. Kohëzgjatja mesatare e projektit ishte tetë muaj.




Grafiku 7 ilustron temat e ndryshme që janë adresuar përmes projekteve të anëtareve të RrGK-së. Konkretisht, 26% e granteve adresuan dhunën me bazë gjinore, 20% synonin të avancojnë të drejtën e grave për qasje në kujdes shëndetësor, 17% u fokusuan në fuqizimin ekonomik të grave, 15% përfshinin avokimin për mundësi të barabarta në edukim, 5% përfshinin ndihmën humanitare dhe vetëm 1% përfshinte mbështetjen organizative, drejt mbështetjes së funksioneve dhe kapaciteteve themelore të organizatës.




Sa i përket financimit për projektet e anëtareve të RrGK-së në vitin 2022, shumica e fondeve të raportuara nga anëtarët kanë shkuar në adresimin e dhunës me bazë gjinore: 1,360,628 € (Grafiku 8). Së dyti, projektet në drejtim të avancimit të të drejtave të grave për qasje në kujdes shëndetësor kanë marrë 701,057 €. Projektet për fuqizimin ekonomik të grave siguruan 636,758€. Projektet që mbështesin mundësitë e shkollimit për gratë dhe vajzat morën 437,656 €, ndërsa projektet që rrisin pjesëmarrjen e grave në politikë dhe vendimmarrje morën 353,828 €. Mbështetja organizative mori 92,657 €, kurse projektet e ndihmës humanitare morën 81,600 €.

Grafiku 8. Shuma e fondeve për projektet në vitin 2022 sipas temave kryesore



Gjatë vitit 2022, shumica e projekteve për të cilat anëtarët e RrGK-së kanë raportuar se i kanë marrë kanë ardhur nga qeveria (40%). Ndërkohë, 28% kanë pranuar fonde nga OJQ-të vendore, nga të cilat 69% e këtyre fondeve kanë ardhur nga FGK. Përveç kësaj, 15% e anëtarëve të RrGK-së kanë marrë mbështetje nga organizatat ndërkombëtare, 12% nga donatorë bilateralë (vendet individuale) dhe 2% nga donatorët multilateralë si agjencitë e OKB-së apo BE-ja. Grafiku 9 ilustron llojet e donatorëve që mbështetën anëtarët e RrGK-së në vitin 2022.

Grafiku 9. Llojet e donatorëve që mbështetën anëtarët e RrGK-së në 2022



Më shumë se 99% e anëtarëve të RrGK-së që kanë marrë grante kanë thënë se kanë përgatitur dhe dorëzuar raporte narrative dhe financiare tek donatorët e tyre. Megjithatë, vetëm 17% e anëtarëve të RrGK deklaruan se kanë bërë auditim organizativ vjetor për vitin 2022.


Në lidhje me hapësirat e zyrave, shumica e anëtarëve të RrGK-së (68%, 93 organizata) thanë se kanë objekte të dedikuara për zyrë për punën e tyre.

V. VIZIBILITETI


Pothuajse të gjitha anëtarët e RrGK-së kanë logon e organizatës (99%). Të gjithë publikojnë dhe promovojnë punën e tyre në një farë mënyre. Facebook-u është platforma më e përdorur për promovimin e punës së tyre (83%). Ndërkohë, 31% e organizatave përdorin Instagramin, dhe 22% kanë faqe interneti për të informuar publikun për punën e tyre. Disa organizata, afërsisht 10% e tyre, përdorin gjithashtu teknologjinë e telefonave inteligjentë (kryesisht Viber) për të informuar përfutuesit e tyre rreth aktiviteteve të ardhshme. Vetëm 39% e anëtarëve të RrGK-së përgatisin raportin vjetor dhe më pak se 1% shpërndajnë dhe promovojnë raportin e tyre vjetor.

VI. SFIDAT DHE NEVOJAT


Mungesa e fondeve mbetet sfida kryesore e identifikuar nga shumica e anëtareve të RrGK-së (93%), duke përfshirë edhe ato me të ardhura më të mëdha vjetore. Stafi i pamjaftueshëm ishte sfidë për 46% të anëtareve dhe 24% u mungonin objektet e zyrës. Disa organizata identifikuan gjithashtu si sfida përfaqësimin e tyre të pamjaftueshëm politik (16%), kërcënimet ndaj grave mbrojtëse të të drejtave të njeriut (10%), mungesën e pajisjeve të zyrës (8%), qasjen e dobët në transport (4%) dhe mundësitë e pamjaftueshme për ngritjen e kapaciteteve (3%) (shih grafikun 10).



Anëtarët u pyetën se cilat shërbime presin nga RrGK-ja. Siç ilustron grafiku 11, shumica (62%) u përgjigjen se kanë nevojë për grante afatgjata. Më shumë se gjysma (52%) thanë se grantet e mbështetura nga FGK kërkojnë punë administrative të konsiderueshme që marrin shumë kohë; ato do të preferonin të kalonin kohën e tyre duke u fokusuar në zbatimin e iniciativave me ndikim. Më shumë se gjysma e anëtareve (51%) gjithashtu përmendën se kanë nevojë për grante më të mëdha, kurse 18% kërkuan grante më fleksibël. Disa anëtare deklaruan se do të preferonin thirrje më të shpeshta për propozime nga FGK-ja.



Lidhur me zhvillimin e kapaciteteve (Grafiku 12), 47% e anëtareve deklaruan se kanë nevojë për më shumë informata rreth mundësive të ndryshme për ngritjen e kapaciteteve (p.sh. trajnime, punëtori,



seminare). Gati gjysma e anëtareve të RrGK-së (47%) kanë nevojë për mbështetje në fushën e menaxhimit financiar. Më tej, 45% deklaruan se kanë nevojë për mbështetje në planifikimin strategjik. Kjo sugjeron që pothuajse të gjitha anëtarët e RrGK-së që nuk kanë strategji janë të vetëdijshme për rëndësinë e planifikimit strategjik. Për më tepër, 32% e anëtareve thanë se kanë nevojë për më shumë informata rreth mundësive të financimit, 16% kanë nevojë për mbështetje në mbledhjen e fondeve, 14% duan mbështetje në përmirësimin e përfaqësimit të tyre politik, 7% në marrëdhëniet me publikun dhe 6% në avokim.

REKOMANDIME PËR NGRITJEN E KAPACITETEVE PËR ANËTARET

- Të vazhdohet kryerja e Vlerësimeve të Kapaciteteve Organizative dhe Avokuese për anëtarët e RrGK-së.
 - Të vazhdohet mbështetja e anëtareve të RrGK-së në hartimin dhe zbatimin e planeve të tyre të personalizuar për zhvillimin e kapaciteteve.
 - Të vazhdohet të ofrohen mundësitë e “të mësuarit përmes veprimit” për anëtarët e RrGK për të:
 - zhvilluar plane strategjike të personalizuar dhe buxhete organizative.
 - zhvilluar dhe zbatuar rregulloren e punës dhe standarde të sjelljes.
 - hartuar projekt propozime për donatorë të tjerë.
 - organizuar dhe mbajtur takime avokuese me përfaqësues institucionalë.
 - publikuar dhe promovuar më mirë punën e tyre (përfshirë edhe përmes Facebook-ut).
 - përgatitur dhe shpërndarë raportet e tyre vjetore.
 - aktivizuar bordet e tyre.
 - Të ndahen më shumë informata me anëtarët rreth mundësive të financimit.
- Të zhvillohen plane për vullnetarë të cilët mund të mbështesin anëtarët e RrGK-së në: përpilimin e projekt propozimeve, marrëdhëniet me publikun, hulumtimin, logjistikën, raportimin, menaxhimin financiar dhe TI.
- Të mbështeten anëtarët në avokim në nivel lokal për të siguruar objektet e zyrës (aty ku është e mundur). Të qasen komunat për të kërkuar nga to hapësira për RrGK-në dhe anëtarët e saj si pjesë e Strategjisë së RrGK për Mobilizimin e Burimeve.
- Të shfrytëzohet dhoma e takimeve e RrGK-së nga anëtarët që kanë nevojë për hapësirë për avokim dhe takime të tjera, ndoshta përmes një procesi të koordinuar regjistrimi online.
- Të vazhdohet identifikimi dhe shpërndarja e pajisjeve të zyrës si donacione për anëtarët.
- Duke marrë parasysh që anëtarët e RrGK-së kanë thënë se arrijnë afërsisht 135 persona në vit, më shumë se 97,172 përfitues në total - të punohet me anëtarët për të zhvilluar një plan të përbashkët komunikimi për përhapjen më të mirë të informacionit tek këta përfitues të ndryshëm, duke përfshirë përmirësimin e shtrirjes së postimeve të RrGK-së në mediat sociale.
- Të zhvillohen mekanizmat më të mirë të konsultimit të anëtarësimit, duke përfshirë mbledhjen e shpejtë të të dhënave dhe marrjen e pëlqimit për çështje të ndryshme

REKOMANDIME KYÇE PËR FONDIN E GRAVE TË KOSOVËS

- Të ofrohen grante afatgjata: Kjo mund të përfshijë financimin për një vit ose për një periudhë prej vitesh. Kjo do të siguronte stabilitet më të madh për organizatat dhe punën e tyre.
- Të sigurohen grantet më të mëdha: Rritja e madhësisë së granteve mund të sigurojë mbështetje më thelbësore për organizatat dhe iniciativat e tyre. Kjo mund të ndihmojë organizatat të ndërmarrin projekte më të mëdha dhe më të ndërlikuar që kërkojnë burime më të mëdha, si dhe të ndërmarrin iniciativa më afatgjata.

- Të vazhdohet të ofrohen grante për mbështetjen organizative: Këto sigurojnë financim për operacionet dhe infrastrukturën kryesore të një organizate, në vend të projekteve ose iniciativave specifike. Duke ofruar mbështetje institucionale, RrGK mund të ndihmojë në ngritjen e kapaciteteve të anëtareve të RrGK-së dhe t'u mundësojë atyre që të fokusohen më shumë në punën e tyre. Mbështetja organizative gjithashtu lejon financim më fleksibël, i cili mund t'u mundësojë organizatave të përdorin fondet në mënyrat që adresojnë më mirë nevojat e tyre, në vend që të lidhen me një projekt apo aktivitet specifik. Kjo do t'u siguronte organizatave autonomi dhe fuqi më të madhe vendimmarrëse, duke u mundësuar atyre kështu të jenë fleksibël me rastin e ndryshimit të situatave politike, ekonomike dhe sociale.
- Të përdoret një përzjerje e llojeve të ndryshme të granteve: Siç ilustron ky vlerësim, anëtarët e RrGK-së janë të ndryshme dhe mu për këtë kanë nevojë për lloje të ndryshme financimi. Dhënia e granteve të vogla për organizatat më të vogla, si dhe grantet më të mëdha, afatgjata dhe mbështetje organizative për organizatat më të mëdha mund të ndihmojë në mbështetjen e diversitetit të kapaciteteve dhe nevojave të anëtareve të RrGK-së.
- Të zvogëlohet barra administrative: Kjo mund t'u mundësojë organizatave të shpenzojnë më shumë kohë dhe burime në punën e tyre.
- Të hapen më shpesh thirrjet për propozime: Rritja e shpeshtësisë së thirrjeve për propozime do të ofronte më shumë mundësi për organizatat që të aplikojnë për financim. Kjo mund të sigurojë që më shumë organizata të marrin mbështetje dhe të kenë burime të vazhdueshme, duke parandaluar kështu lëvizjen e stafit dhe ngecjet në veprimet e tyre avokuese.

SHTOJCA 1. APLIKACION PËR ANËTARËSIM NË RrGK

Misioni i Rrjetit të Grave të Kosovës (RrGK) është që të përkrahë, të mbrojë dhe të promovojë të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në të gjithë Kosovën, pavarësisht nga përkatësia e tyre politike, fetare, etnike, mosha, niveli i arsimit, orientimi seksual dhe aftësia. RrGK e realizon këtë mision përmes shkëmbimit të përvojës dhe informatave, partneriteteve dhe rrjetëzimit, hulumtimeve, avokimit dhe shërbimeve.

Emri i Organizatës dhe Shkurtesa	
Drejtori/ja ekzekutiv/e i/e organizatës	
Telefoni	
E-maili	
Adresa e plotë e zyrës, Qyteti	
Viti i themelimit të organizatës	
A jeni organizatë anëtare në RrGK?	Po Jo
Nëse po, në cilin vit jeni anëtarësuar?	

I. Misioni dhe Programi

1. Cili është misioni ose qëllimi i organizatës tuaj sipas statutit? *Ju lutemi shënoni.*

Ju lutemi e bashkëngjitni statutin

Bashkangjitur

1. A ka organizata juaj strategji?

Po Jo

Nëse po, ju lutemi e bashkëngjitni

Bashkangjitur

2. Ju lutemi shënoni **tri** fushat kryesore të veprimtarisë së organizatës suaj:

Fushëveprimi	Bëni me shenjë këtu
Bujqësi	
Kulturë	
Fuqizim ekonomik	
Edukim/arsimim	
Mbrojtja e Mjedisit	
Përkrahje për grupe etnike	
Adresimi i dhunës me baza gjinore, dhuna në familje, anti-trafikimi (përfshirë strehimoret)	
Barazi gjinore	
Shëndetësi	
Të drejtat e njeriut, të drejtat e grave, të drejtat e fëmijëve	
Ndihmë humanitare	
Ndihmë ligjore	
Përkrahja e personave me nevoja të veçanta	
Fuqizim politik, rritja e pjesëmarrjes së grave në politikë/vendim-marrje	
Ndihmë psiko-sociale, rehabilitim, riintegrim	
Paqja dhe siguria	
Tjetër (shënoni):	

II. Qeverisja e mire

3. A ka organizata juaj Bord?

Po Jo

4. Sa anëtare të Bordit keni?

5. Ju lutemi, shënoni emrat e anëtareve të Bordit tuaj aktual:

6. Sa herë në vit mbahen mbledhjet e Bordit? _____

7. Sa herë është takuar Bordi gjatë vitit të fundit (p.sh. 2022)?

8. A jeni organizatë me anëtarësi? Po Jo

9. Nëse po, sa anëtarë i keni në organizatë? _____

10. A ka organizata juaj rregullore të punës? Po Jo

Nëse po, ju lutemi e bashkëngjitni

Bashkangitur

III. Resurset njerëzore

1. A keni staf? Po Jo

2. Nëse po, sa? _____

3. Sa janë paguar rregullisht këtë vit?

4. A keni vullnetarë? Po Jo

5. Nëse po, sa? _____

6. A keni nevojë për vullnetarë? Po Jo Ndoshta

7. Nëse po, për çfarë saktësisht? Ju lutemi zgjidhni fushat kryesore në të cilat keni nevojë për përkrahje të vullnetarëve:

a) Shkrim të projekt propozimeve

b) Raportim

c) Takimet me anëtare

d) Marrëdhëniet me publikun

e) Hulumtime

f) Tjetër (shënoni): _____

8. Sa përfitues/e ka pasur organizata juaj gjatë këtij viti (2022) përmes punës suaj (ose vitin e kaluar nëse tani është fillimi i vitit)?

IV. Transparenca dhe përgjegjësia financiare

1. A keni buxhet vjetor? Po Jo

2. Cili është viti i fundit kur keni marrë grant nga ndonjë donator? _____

3. Sa janë të hyrat vjetore në organizatën tuaj gjatë këtij viti?

Shënoni: _____

4. Nëse keni siguruar fonde gjatë këtij viti, ju lutemi plotësoni tabelën në vazhdim:

#	Titulli i projektit	Periudha e projektit	Vlera e projektit	Donatori
1				
2				
3				
4				
5				

5. A i keni dorëzuar donatorëve raport narrativ dhe financiar mbi punën tuaj? Po Jo
6. A keni bërë auditim vjetor? Po Jo

V. Vizibiliteti

1. A ka organizata juaj logo? Po Jo
2. A keni ueb faqe të organizatës? Po Jo
3. Nëse po, shënoni: _____
4. A keni faqe apo grup në Facebook? Po Jo
- Nëse po, shënoni: _____
5. A keni llogari në Instagram? Po Jo
- Nëse po, shënoni: _____
6. A keni raport vjetor mbi punën dhe financat e organizatës tuaj? Po Jo
7. A e informoni publikun mbi aktivitetet e organizatës suaj? Po Jo
8. Nëse po, si? Shënoni: _____

VI. Sfidat dhe nevojat

1. Cilat janë sfidat kryesore me të cilat ju përballeni në punën tuaj të përditshme? Ju lutem zgjidhni nga sfidat e renditura më poshtë:

- Mungesë e financimit
- Mungesë e stafit
- Mungesë e përfaqësimit politik
- Kërcënimet ndaj grave mbrojtëse të të drejtave të njeriut.
- Tjetër (shënoni): _____

2. Çfarë prisni nga RrGK të ju ofrojë juve si organizatës anëtare? Ju lutem zgjidhni nga shërbimet e mëposhtme:

- Grante më të mëdha
- Grante afatgjata (më gjatë se 1 vit)
- Grante më fleksibile
- Grante me më pak administratë si?
- Mbështetje në zhvillimin e kapaciteteve çfarë?
- Mbështetje në menaxhim financiar
- Mbështetje në planifikim strategjik
- Mbështetje në përfaqësim politik (si takime me zyrtarët)
- Më shumë informata rreth mundësive për financim
- Më shumë informata rreth mundësive të ndryshme për ngritje të kapaciteteve (si trajnime, punëtori, mentorime, vizita studimore etj.)
- Tjetër (shënoni): _____

Unë, _____ (emri dhe mbiemri), pajtohem që detajet kontaktuese dhe misioni të përdoren për të përditësuar profilin e organizatës sonë në ueb faqen e RrGK-së.

Unë, _____ (emri dhe mbiemri), deklaroj se të gjithë anëtarët, stafi, dhe konsulentët e jashtëm të organizatës do të respektojmë, promovojmë dhe përkrahim misionin e Rrjetit të Grave të Kosovës dhe do ta zbatojmë Rregulloren dhe Kodin e Mirësjelljes së Anëtarësisë.

Nënshkrimi juaj: _____

Data: _____